



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



PROGRAM

Drejtimi: **Gjeografi**

Lënda: GJEOMORFOLOGJI E SHQIPËRISË

<i>Pedagogu:</i>	Prof.Dr. Gjovalin Gruda
<i>Ngarkesa:</i>	3 ETCS (18 orë leksione dhe 18 orë seminare)
<i>Lloji i lëndës:</i>	Me zgjedhje
<i>Programi i studimit:</i>	Master i Shkencave, gjeografi
<i>Viti/semestri:</i>	I/II

Shkurtesë: Trajtat e larmishme morfologjike, morfogjenetike dhe morfokronologjike të relievit të Shqipërisë, janë formuar në sajë të bashkeveprimit reciprok e të perhershëm ndërmjet faktoreve të brendshme dhe atyre të jashtëme, ku prej këtyre të fundit, janë krijuar e zhvilluar shumë dukuri relievformuese, të cilat drejtojnë evolucionin morfologjik të trajtave të ndryshme të relievit. Formimi dhe modelimi i relievit strukturor fillon njëherazi me ngritjen dhe daljen mbi ujë të njësisë morfotektonike të Albanideve gjatë etapave të ndryshme të evolucionit morfotektonik. Kjo dalje është shoqëruar me veprimin e fuqishëm të dukurive morfogjenetike të jashtëme në kushtet kontinentale të zhvillimit, duke çuar në krijimin e sipërfaqeve të sheshimit dhe kores së tjetërsimit. Relievi është pasojë e bashkeveprimit të faktoreve tektonike, litologjike dhe atyre erozive, duke kushtezuar formimin e trajtave gjenetike perkatese. Kushtet e një tektonike aktive në ditët e sotme, e shoqëruar njëherazi me një fuqizim të theksuar të dukurive morfogjenetike të jashtëme, është një nga faktorët vendimtarë të formimit dhe modelimit të relievit në tërësi dhe atij strukturor në veçanti. Kjo lidhje e ngushtë midis tektonogjenezës dhe morfogjenezës shprehet mjaft mirë tek periudhat e evolucionit të relieveve strukturore të lartpërmendura, ku çdo etapë e formimit të strukturave shoqërohet në vijueshmëri me krijimin e një relievi malor kompleks origjinal dhe me kontraste morfologjike të theksuara.

Temat e leksioneve

1. Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia. Historiku i studimeve mbi terriorin e vendit tone
2. Ndikimi i faktorëve fiziko-gjeografike. Ndërtimi gjeologjik, Litologjia, tektonik, evolucioni morfotektonik dhe morfoklimatik dhe veçoritë sizmike. Analiza e faktoreve dhe e faktoreve gjenetike të relievit.
3. Ndikimi i klimës, hidrografisë, tokave dhe bimësisë në reliev. Veçoritë morfologjike. Veçoritë morfografike, morfometrike, hipsometrike, dendësia e copëtimit të relievit, thellësia e copëtimit të relievit, ekspozicioni i shpateve dhe pjerrësia e shpateve.
4. Raporti ndërmjet morfologjisë me morfostrukturat e relievit të Shqipërisë. Trajtat e relievit të zhvilluara në strukturat aklinale, monoklinale, antiklinale e sinklinale dhe në strukturat shkeputese.
5. Raporti i rrjetit lumor me strukturën gjeologjike. Format e mospershtatjes. Epigjeneza me antecendence ose paravendosje dhe epigjeneza me mbivendosje.

6. Kompleksi i relievit karstik, i relievit lumor, relievit akullnajor, i relievit bregdetar dhe dukuritë shpatore
7. Karakteristikat morfologjike të kurrizeve malore të formuar në Alpet e Shqipërisë.
8. Vecoritë morfologjike të fushegropave, gropave, pragjeve e shkalleve strukturore në Shqipëri.
9. Tiparet morfologjike të luginave të Drinit të Zi, Matit, Erzenit, Shkumbinit, Osunit, Devollit dhe të Vjoses.
10. Kushtet morfotektonike të formimit të Ultesirës Perendimore me sektoret kodrinore kufizues
11. Zhvillimi i gjeomorfologjisë së aplikuar në funksion të shoqërisë humane në Shqipëri

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursit ose ESE: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura bazë:

Aliaj.Sh. Melo.V.	Disa tipare të evolucionit morfotektonik të relievit të vendit tonë.Bul. Studime gjeografike. Nr. 2. 1987. Tiranë.1.
Derruau.M	"Precise de Geomorphologie. Paris 1966.
2. Dumas.B.	Le Levant espagnol. La genese du relief, Paris, 1977.
3. Gruda Gj.	Gjeomorfologjia. Tekst mësimor. 2003.
4. Spaho.Sh.	Tokat. Gjeo Fiz Shqipërisë. Vol.1.1990.
Kolektiv autoresh.	Gjeografia Fizike e Shqipërisë. Nr.1 – Nr.2. Tirane 1990
5. Kolektiv autoresh.	Harta e zonave klimatike të Shqipërisë. Shk 1:200000. 1981.
6. Kolektiv autorësh.	Harta Neotektonike e Shqipërisë në shkallën 1:200000 dhe teksti sqarues i saj. (Studim i Neotektonikës së Shqipërisë dhe veçoritë gjeologjike të saj). 1996.
7. Kolektiv autorësh.	Harta e Hidrografisë së Shqipërisë. Sh.B.L.Sh. Tiranë 1978.
8. Kolektiv autorësh.	Harta tektonike e Shqipërisë. 1:200000. 1985.
9. Kolektiv autorësh.	Harta gjeologjike e Shqipërisë. Shk 1:200000.2002.
10. Castiglioni.G.B.	Geomorfologia. Seconda edizione. 1992. Torino.
11. Panizza.M.	Geomorfologia. Bologna 1992.
12. Panizza.M	Geomorfologia applicata Bologna 1988.
13. Paskoff, R. (1994)	Les Littoraux. Impact des Aménagements sur leur Evolution (2-edition). Masson, Paris.
14. Summerfield. S.	Global Geomorphology. New York. 1991.
15. Tricart. J.	Principes et Methodes de Geomorphologie. Paris 1965.

MIRATOI

**Përgjegjësi i Departamentit
Prof. dr. Romeo HANXHARI**

Tiranë, 2017